

STATUT I FEDERATES SHQIPTARE TE FUTBOLLIT

PERMBAJTJA

STATUT I FEDERATES SHQIPTARE TE FUTBOLLIT	1
PERMBAJTJA	1
I. PERCAKTIMI I TERMAVE.....	4
II. HYRJE	4
III. RREGULLA TE PERGJITHSHME	4
Neni 1	4
Forma ligjore, Selia	4
Neni 2	5
Shkurtimi, Flamuri, Emblema, Vula dhe Gjuha.....	5
Neni 3	5
Objektivat.....	5
IV. ANETARET	6
Neni 4.....	6
Kategorite e anetareve.....	6
Neni 5.....	6
Kushtet per anetaresim.....	6
Neni 6.....	7
Procedura per te marre statusin e anetarit.....	7
Neni 7	7
Vendime mbi anetaresimin	7
Neni 8.....	7
Neni 9.....	7
Te drejtat e anetareve.....	7
Neni 10.....	8
Detyrimet e anetareve	8
Neni 11.....	9
Doreheqja e nje anetari	9
Neni 12.....	9
Pezullimi	9
Neni 13.....	9
Perjashtimi.....	9
Neni 14.....	9
Humbja e antaresise per shkak te perjashtimit.....	9
Neni 15.....	9
Shperberja	9
Neni 16.....	10
Humbja e anetaresise per shkak te Shperndarjes	10
Neni 17.....	10
Raste te vecanta	10
V. ORGANIZATA.....	10
Neni 19.....	10
Lista e organeve.....	10
A. Asambleja e Pergjithshme.....	11
Neni 20.....	11
Percaktimi, perberja dhe Komisioni i Verifikimit.....	11

Neni 21	11
Emerimi i delegateve	11
Neni 22	11
Numri dhe percaktimi i delegateve	11
Neni 23	12
Fushat e autoritetit (kompetencat)	12
Neni 24	12
Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme	12
Neni 25	12
Rendi i dites per Asamblene e Pergjitheshme te Zakonshme	12
Neni 26	13
Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme	13
Neni 27	13
Numri i duhur i votave (Quorum)	13
Neni 28	14
Drejtimi i Asamblese se Pergjithshme	14
Neni 29	14
Marrja e Vendimeve	14
Neni 30	14
Zgjedhjet.....	14
B. Komiteti Ekzekutiv	15
Neni 31	15
Perberja.....	15
Neni 32	16
Kohezgjatja e mandateve	16
Neni 33	16
Mbledhjet.....	16
Neni 34	16
Kompetencat	16
Neni 35	17
Vendim-marrjet	17
Neni 36	18
Presidenti	18
Neni 37	18
E drejta e firmosjes	18
C. Organet e kontrollit financiar.	18
Neni 38	18
Kontrollues te pavarur	18
D. Organet gjykuese	19
Neni 39	19
Dispozita te pergjithshme	19
Neni 40	19
Pavaresia dhe Abstenimi	19
Neni 41	19
Komisioni Disiplinor	19
Neni 42	20
Komisioni i Apelit	20
Neni 43	21
Inspektoret e Disiplines.....	21
Neni 44	21
Lista e masave disiplinore	21

E.	Sekretariati i pergjithshem	22
	Neni 45	22
	Detyrat	22
	Neni 46	22
	Sekretari i Pergjithshem	22
VI.	FINANCA	23
	Neni 47	23
	Periudha financiare.....	23
	Neni 48	23
	Te ardhurat.....	23
	Neni 49	23
	Shpenzimet.....	23
	Neni 50	23
	Parimet e llogarise	23
VII.	GARAT DHE TE DREJTAT NE GARA DHE EVENIMENTE	23
	Neni 51	23
	Organizimi i ndeshjeve.....	23
	Neni 52	24
	Pjesemarja ne garat e klubeve	24
	Neni 53	25
	Integriteti sportiv i kompeticioneve kombetare, ngjitja dhe renia nga kategoria, si dhe bashkepronesia.....	25
	Neni 55	25
	Te drejtat (duke perfshire te drejtat e medias, etj)	25
VIII.	SHPERBERJA.....	26
	Neni 56	26
	Vendimet.....	26
	Neni 57	26
	Dispozitat mbi pasurite	26
IX.	DISPOZITA PERFUNDIMTARE	26
	Neni 58	26
	Ceshtje qe nuk jane parashikuar ne Statutet	26
	Neni 59	26
	Miratimi dhe data e hyrjes ne fuqi	26
	Neni 60	Error! Bookmark not defined.
	Dispozita te perkoheshme.....	Error! Bookmark not defined.

I. PERCAKTIMI I TERMAVE

Ne interpretimin e termave te ketij Statuti dhe te Rregulloreve te Federates Shqiptare te Futbollit fjalet dhe shkurtimet e meposhtme perfaqesojne (sipas rendit alfabetik):

- “Gjykata e Arbitrazhit”: Gjykate e vetme e pavarur dhe e pa anshme ose nje panel arbitrazhi e krijuar nga persona private, qe vepron ne vend te nje gjykate te zakonshme brenda qellimit dhe fuqive te caktuara ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi.
- “Asambleja”: do te nenkuptoje Asamblene e Pergjithshme si organ me i larte te FSHF-se.
- “CAS”: do te thote Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ne Lausanne (Zvicer).
- Komiteti Ekzekutiv, ose KE”: do te nenkuptoje organin Ekzekutiv te FSHF-se, i cili funksionon ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.
- “FIFA” do te nenkuptoje Federaten Nderkombetare te Shoqatave te Futbollit.
- “FSHF” ose “Federate” do te nenkuptoje Federaten Shqiptare te Futbollit.
- “IFAB” do te thote Bordi Nderkombetar i Shoqatave te Futbollit, i cili nxjerr dhe modifikon Ligjet e Lojes.
- “Liga” do te nenkuptoje kombinim ose grup klubesh brenda territorit te FSHF-s, e cila varet dhe eshte nen autoritetin e FSHF-s.
- “Zyrtar”: do te nenkuptoje nje anetar te nje bordi/organizate, anetar Komisioni, traineret, arbitrat dhe asistentet e arbitrave, zyrtaret e katert, personat pergjegjes per ceshtjet teknike, mjekesore dhe administrative ne FSHF dhe anetaret e FSHF-se.
- “Gjykata e Zakonshme”: Gjykata me juridiksion te zakonshem ne Shqiperi, qe marrin vendime ne lidhje me mosmarreveshje, ne baze te kompetencave te tyre sikurse eshte vendosur ne Kushtetuten e Shqiperise dhe nga legjislacion tjetere Shqiptar.
- “Lojtar”: do te nenkuptoje nje futbollist te regjistruar ne FSHF.
- “UEFA” do te nenkuptoje Bashkimin e Shoqatave Europiane te Futbollit.

II. HYRJE

Federata Shqiptare e Futbollit eshte themeluar me 6 Qershor 1930 dhe eshte anetare e Federates Nderkombetare te Shoqatave te Futbollit (FIFA-s) prej vitit 1932 dhe e Bashkimit te Shoqatave Europiane te Futbollit (UEFA) prej vitit 1954. Federata Shqiptare e Futbollit eshte anetare e Komitetit Olimpik Shqiptar dhe organi i vetem kompetent per te organizuar futbollin ne territorin e Shqiperise.

III. RREGULLA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore, Selia

1. Federata Shqiptare e Futbollit eshte person juridik, shoqate, e cila perfaqeson bashkimin vullnetar te shoqatave dhe klubeve sportive te futbollit ne Republiken e Shqiperise, te cilat veprojne ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit Nr.8789, date 27.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”, Ligjit Nr.79/2017 “Per Sportin”, dhe akte te tjera ligjore e nenligjore qe drejtojne kete aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Futbollit eshte e detyruar te respektojte statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet FIFA-s dhe UEFA-s.
3. Federata eshte asnjehanes ne ceshtjet politike dhe fetare.

4. Diskriminimi i cdo lloji kunder nje vendi tjetër, personi privat ose grupi njerezish ne lidhje me origjinen etnike, gjinore, gjuhen, fene, politikat ose ndonje aresye tjetër eshte krejtisht e ndaluar dhe denohet me pezullim, perjashtim, ose ndonje vendim tjetër disiplinor.
5. Federata eshte themeluar per nje periudhe te pakufizuar kohe dhe ka pavaresi te plote teknike, organizative dhe administrative ne zbatimin e veprimtarive te saj. Ajo respekton autoritetin e shtetit.
6. Selia e saj ndodhet ne qytetin e Tiranës ne adresen Rruga Liman Kaba
7. Asambleja e Pergjithshme, me propozim te Komitetit Ekzekutiv te FSHF vendos per ndryshimin e selise se FSHF-se.

Neni 2

Shkurtimi, Flamuri, Emblema, Vula dhe Gjuha.

1. Federata Shqiptare e Futbollit perdor shkurtimin “FSHF”.
2. Emblema dhe flamuri i FSHF-se perbehet nga Mbishkrimi “FSHF 1930”.
3. Vula eshte rrethore dhe perfshin emblemen e FSHF-se.
4. Gjuha zyrtare e FSHF eshte Shqipja.
5. Emblema, e FSHF është Markë e Regjistruar sipas Ligjit “Për Pronësinë Industriale”

Neni 3

Objektivat

1. FSHF eshte organizate jofitimpruese. Prandaj, cdo e ardhur qe fitohet do te ri-investohet ne aktivite te futbollit ose ne dobi te anëtarëve të sajë.
2. FSHF ndjek objektivat e meposhtme:
 - a. Të zhvilloje, promovojë, organizojë, drejtojë, kontrolloje dhe vëzhgojë aktivitetet sportive në nivel kombëtar në sportin e futbollit në territorin e Republikës se Shqiperise, ne përputhje me Ligjin, Statutin, rregulloret dhe direktivat e adoptuar nga FIFA dhe UEFA.
 - b. Të organizojë kampionatet kombëtar të futbollit dhe dhe Kupën e Shqipërisë si dhe të gjitha aktivitetet e tjera futbollistike në të gjitha format në Republikën e Shqipërisë .
 - c. Te kontrolloje dhe mbikëqyre te gjitha ndeshjet miqësore dhe zyrtare te futbollit te te gjitha formave te luajtura ne Republikën e Shqiperise.
 - d. Të organizojë ekipet kombëtare të futbollit dhe të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare të organizuara nga FIFA dhe/ose UEFA si dhe të liçensojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari
 - e. Te perdore eksperiencen e saj për te ndihmuar rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis anëtareve te FSHF-se, duke inkurajuar frymën e tolerances, te mirekuptimit dhe lojes se drejte (Fair Play) ne te gjitha nivelet e ndeshjeve.
 - f. Të parandalojë praktika jo-etike që mund të dëmtojnë integritetin e lojës së futbollit;
 - g. Të sigurojë perparesine e vlerave sportive mbi interesat tregtare;
 - h. Te organizoje, administroje dhe kontrolloje disiplinën dhe lojën e futbollit ne Republikën e Shqiperise.
 - i. Te perpilojë rregulla dhe të marrë masa për të siguruar zbatimin e tyre
 - j. Te respektojë dhe te ndaloje cdo shkelje te statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve te FIFA-s, UEFA-s, FSHF-se, gjithashtu dhe Rregullat e Lojes dhe te siguroje qe keto rrespektohen gjithashtu nga antaret e saj.
 - k. Te organizoje aktivite te nivelit nderkombetar dhe kombetar

- l. Të promovojë frymën e unitetit mes anëtarëve dhe të mbrojë interesat e përbashkëta të tyre;
- m. Të menaxhojë lidhjet sportive ndërkombëtare lidhur me shoqatën e futbollit në të gjitha format e saj dhe me gjithë partnerët (FIFA, UEFA, shoqatat kombëtare etj.)
- n. Të shfrytëzojë të drejtën e transmetimit të aktiviteteve të organizuara prej sajë, brenda dhe jashtë vendit;
- o. Të ekuilibrojë dhe normalizojë interesat e përgjithshme të futbollit në rastet e mosmarreveshjeve midis anëtarëve;
- p. Të mbështesë dhe përkrahë iniciativat e anëtarëve të saj, për rritjen e të ardhurave të tyre, konform legjislacionit në fuqi.
- q. Të organizojë konferenca, seminare, kurse trajnimi dhe të sigurojë informacion mbi aktivitetet dhe anëtarët e saj.
- r. Të mbajë kontakte dhe të bashkëpunojë me institucionet shtetërore shtetin sidomos në lidhje me strategjinë dhe politikën për zhvillimin e futbollit dhe ato që kanë të bëjnë me legjislacionin për sportin.
- s. Të sigurojë asistencë, sponsorizime, donacione nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si dhe subvencione nga shteti.

IV. ANETARËSIA

Neni 4

Kategoritë e anëtarëve

1. FSHF mund të ketë anëtarë vetëm subjekte që janë njohur dhe regjistruar si të tilla nga organet kompetente shtetërore që përcaktojnë legjislacionin në fuqi. Statutet dhe aktet themelore të këtyre subjekteve duhet të jenë në çdo rast në përputhje me këtë Statut dhe rregulloret apo aktet e tjera të FSHF.
2. FSHF mund të ketë vetëm këto kategori anëtarësh:
 - a. Klube futbollit
 - b. Subjekte që grumbullojnë dhe përfaqësojnë individë që ushtrojnë profesione të lidhura me futbollin.
 - c. Subjekte që grumbullojnë dhe përfaqësojnë klube për kategori specifike futbollistësh që lidhen me moshën, gjininë apo me lloje të vecanta të futbollit.
 - d. Subjekte që grumbullojnë dhe përfaqësojnë klube që i takojnë një rajoni të caktuar gjeografik, bazuar në ndarjen rajonale të përcaktuar nga Asambleja .

Neni 5

Kushtet për anëtarësim

1. Në kuptim të Nenit 4/2/a. të statutit, vetëm pjesëmarrësit në Garat e përcaktuara nga Neni 51/2/i, ii, iv, v mund të jenë anëtar të FSHF. Pjesëmarrësit në garat e tjera duhet të anëtarësohen pranë anëtarëve që grumbullojnë dhe përfaqësojnë klube që i takojnë rajonit përkatës gjeografik
2. Çdo kërkesë për t'u anëtarësuar në FSHF duhet të bëhet me shkrim dhe duhet t'i dërgohet Sekretariatit të Përgjithshëm të FSHF duke e shoqëruar me:
 - a. Një deklaratë që vërteton se kërkuesi ka selinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është i regjistruar si një subjekt ligjor tek autoritetet kompetente.
 - b. Një deklaratë që garanton se kërkuesi do të luajë të gjitha ndeshjet zyrtare vetëm në territorin Shqiptar, përveç rastit kur vendoset ndryshe nga organet kompetente.
 - c. Një deklaratë që siguron se përberja ligjore e kërkuesit garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë palë e tretë apo ent tjetër.

- d. Nje kopje te statuteve dhe rregulloreve te saj, te vlefshme ligjerisht.
 - e. Nje deklarate qe do ti bindet statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve te FSHF, FIFA dhe UEFA si dhe siguron qe keto do te respektohen edhe nga anetaret e tij (zyrtaret dhe lojtaret etj).
 - f. Nje deklarate qe do te respektoje Ligjiet e Lojës botuar nga IFAB dhe Ligjin e Lojrave te Minifutbollit botuar nga Komiteti Ekzekutiv I FIFA-s.
 - g. Nje deklarate qe njeh juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (CAS) në Lausanne (Zvicer).
 - h. Nje liste te zyrtareve, me emrat e personave te autorizuar per firmosje me te drejten per te hyre ne marreveshje ligjore me nje pale te trete.
 - i. Nje deklarate qe merr persiper te organizoje ose te marre pjese ne ndeshje miqesore vetem duke marre me pare miratimin nga FSHF-ja.
 - j. Nje kopje të protokollit te mbledhjes me te fundit te Asamblese se Pergjithshme ose te takimit konstitucional.
 - k. Një vërtetim nga sektori i licensimit pranë FSHF se përmbush kriteret për pjesëmarrje në garën përkatëse.
3. Sekretari i Pergjithshem verteton marrjen e kerkeses per anetaresim te aplikantit.

Neni 6

Procedura per te marre statusin e anetarit

1. Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se miraton rregulloren per anetaresim.
2. Sekretariati i Pergjithshem verifikon plotesimin e kriterëve formale per anetaresim dhe pergatit nje raport me shkrim per Komitetin Ekzekutiv te FSHF-se.
3. Komiteti Ekzekutiv shqyrton kushtet e anetaresise dhe vendos nese kerkesa per anetaresim i ploteson te gjitha kerkesat dhe ben nje rekomandim per Asamblene e Pergjithshme, e cila duhet te vendose per pranimin.

Neni 7

Vendime mbi anetaresimin

1. Asambleja e Pergjithshme e FSHF-se eshte i vetmi organ qe ka te drejte te pranoje nje aplikant si anetar te FSHF.
2. Midis dy Asambleve te Pergjithshme, Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se mund t'i jape anetaresim të përkohshëm nje kandidati, i cili permbush te gjitha kerkesat percaktuar ne Nenin 5 të këtij statuti. Vendimi për pranimin me të drejta të plota i parashtrohet Asambles së Përgjithshme në mbledhjen e rradhës;
3. Anetari i ri duhet te marre te drejtat dhe detyrat e anetarit te sapo ai eshte pranuar. Delegatet kane te drejte te votojne dhe te zgjidhen me efekt te menjehershem.

Neni 8

Forma ligjore e FSHF dhe anetareve te saj

1. FSHF eshte bashkimi ne formen e nje organizate private me natyre shoqate ne perputhje me ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise per organizatat jo-fitimpruresë.
2. Anetaret e FSHF-se krijohen ne nje nga format ligjore te parashikuara ne ligjin per sportin.

Neni 9

Te drejtat e anetareve

1. Anetaret e FSHF kane te drejtat e meposhtme:
 - a. Te pajiset me karten e anetaresimit.

- b. Te njihet me pare me axhenden e cdo Asambleje te Pergjithshme, te ftohet ne takim ne kohen e percaktuar, te marre pjese ne mbledhje dhe te ushtroje te drejten per te votuar.
 - c. Te jete i informuar per veprimtarite e FSHF.
 - d. Te marre pjese ne aktivitetet sportive qe organizohen nen patronazhin e FSHF, ne perputhje me rregulloret e saj.
 - e. Te propozoje kandidatet per organet e FSHF per t'u zgjedhur ne Asamblene e Pergjithshme.
 - f. Te hartoje propozime per rendin e ditës së Asamblese se Pergjithshme.
 - g. Te marre falas raportet vjetore dhe botimet e tjera te FSHF.
 - h. Te gjitha te drejtat e tjera qe dalin nga ky statut ose ato qe njihen nga rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF.
2. Ushtrimi i ketyre te drejtave eshte subjekt i dispozitave te tjera ne keto Statute dhe ne rregulloret e aplikueshme.

Neni 10

Detyrimet e anetareve

1. FSHF dhe anetaret e saj kane detyrimet e meposhtme:
 - a. Te respektoje Ligjin, Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF, FIFA dhe UEFA,.
 - b. Te njohe autoritetin e Gjykates se Arbitrazhit per Sportin (CAS) ne Lozane (Zvicer) sikurse eshte specifikuar ne dispozitat perkatese te Statuteve te FIFA dhe UEFA.
 - c. Çdo mosmarreshje e dimensionit kombetar qe del nga/ose lidhet me zbatimin e statuteve ose rregulloreve të FSHF ose ndonjë kontrate, i duhet referuar nje Gjykate te pavarur dhe te paaneshme te arbitrazhit, qe eshte Gjykata e Arbitrazhit per Sportin ne Lausanne sic eshte specifikuar ne dispozitat perkatese te Statuteve te FIFA dhe UEFA derisa legjislacioni Shqiptar te kete ngritur nje gjykate te pershtatshme arbitrazhi ne Shqiperi e cila ploteson kerkesat minimale te FIFA dhe UEFA. Gjykata e Arbitrazhit per Sportin ne Lausanne do te zgjidhe mosmarreshjet ne vend te ndonje gjykate tjeter te zakonshme, derisa kjo te ndalohet nga legjislacioni ne fuqi ne Shqiperi.
 - d. Te respektojë parimin e besnikërisë, integritetit dhe *fair-play-t* duke mos ndërmarrë veprime kunder interesave te FSHF;
 - e. Te respektoje dhe zbatoje Ligjet e Lojes se IFAB dhe Ligjet e Lojes per Minifutbollin te botuar nga Komiteti Ekzekutiv i FIFA;
 - f. Te siguroje qe anetaret e tij, lojtaret, zyrtaret, agjentet e ndeshjeve dhe te lojtareve njohin dhe pranojne te gjitha detyrimet e permendura me siper;
 - g. Te siguroje qe organi ekzekutiv i tyre eshte i zgjedhur në përputhje me ligjin;
 - h. Te paguaje te gjitha detyrimet financiare ndaj FSHF dhe anetareve te saj.
 - i. Të njoftojë FSHF për ndonje ndryshim në anëtarësi/pronësi, në statutet dhe rregulloret e anetarit si dhe per listen e personave ose zyrtareve te autorizuar per te firmosur me te drejte per te hyre ne marreshje ligjore me pale te treta;
 - j. Te mos mbaje asnje lidhje te natyres sportive me subjekte te panjohura nga FSHF;
 - k. Te njohe te gjitha detyrimet e tjera qe dalin nga keto statute, rregullore, direktiva dhe vendime te FSHF.
 - l. Te zbatoje detyrimet ne nenin 5 per periudhen kohore te anetaresimit te tyre
2. Anetaret e FSHF-se duhet te integrojne ne statutet e tyre detyrimet e lartpermendura per anetaret e tyre.
3. Shkelja e detyrimeve te lartpermendura nga ndonje anetar mund te sjelle sanksione te parashikuara ne kete Statut.

Neni 11

Doreheqja e nje anetari

1. Një anëtar i FSHF mund të japë dorëheqje nga anëtarësia në fund të vitit financiar me kusht që të ketë shlyer më parë të gjitha detyrimet financare ndaj FSHF ose anëtarëve të tjerë.
2. Kërkesa për dorëheqje i paraqitet me shkrim për Komitetit Ekzekutiv të FSHF të pakten 6 muaj përpara përfundimit të sezonit sportiv.

Neni 12

Pezullimi

1. Shkelja serioze e statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHF mund të rezultojë në pezullimin e anetarit nga FSHF për një periudhë deri në 2 (dy) vjet maksimum, në bazë të vendimit nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Në rast të urgjente Komiteti Ekzekutiv mund të pezullojë perkohesisht një anëtar. Në një rast të tillë, pezullimi është në fuqi deri në Asamblenë e Përgjithshme të radhës, e cila merr një vendim në lidhje me këtë masë.
3. Anëtar i pezulluar humbet menjëherë të drejtat e tij të anëtarësisë vecanerisht të drejtën për të votuar në Asamblenë e Përgjithshme dhe të propozojë kandidatë për zgjedhje në organet e FSHF.
4. Komisioni i Disiplinës mund të imponojë vendosë sanksione të metejshme.

Neni 13

Perjashtimi

Asambleja e Përgjithshme mund të perjashtojë një anëtar për shkelje serioze ose të perseritura të Statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHF.

Neni 14

Humbja e antaresise per shkak te perjashtimit

1. Kërkesa për perjashtimin e një anetari të FSHF mund të parashtrohet Asamblese së Përgjithshme nga Komiteti Ekzekutiv me anë të kërkesës me shkrim dhe baza të forta të:
 - a. Komiteti Ekzekutiv i FSHF ose;
 - b. Organi Gjyqësor i FSHF
2. Për sa një kërkesë e tillë të parashtrohet Asamblese së Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv mund të kërkojë Komisionit Verifikues ta studiojë kërkesën dhe të hartojë një draft me opinion ligjor për Asamblenë e Përgjithshme.
3. Anëtar i një fjale ka të drejtë të degjohet dhe i kërkohet të parashtrorë deklaratën e tij me shkrim në lidhje me kërkesën për perjashtim. Një anëtar i tillë mund të kërkojë gjithashtu të prezantojë Asamblese së Përgjithshme një deklaratë të shkurtër.
4. Asambleja e Përgjithshme e merr vendimin duke u bazuar në Nenin 28 me efekt të menjëhershëm, në qoftë se nuk vendos ndryshe. Thyerja serioze e Statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHF mund të rezultojë në pezullimin e anetarit nga FSHF për një maksimum prej dy vjetësh, sic mund të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 15

Shperberja

Shperberja e një enti ligjor të një anetari mund të jetë vullnetare ose ligjore. Në secilin rast rezulton në humbjen e statusit të anetarit të FSHF, madje përpara se të arrihet faza e likuidimit.

Neni 16

Humbja e anetaresise per shkak te Shperndarjes

1. Nese nje anetar i FSHF shperndahet per ndonje arsye ligjore ne baze te ligjit kombetar, anetaresia e tij me FSHF do te perfundoje ne te njejten kohe qe personaliteti ligjor pushon se ekzistuari.
2. Organi Ekzekutiv i anetarit te tille ka per detyre te informoje Komitetin Ekzekutiv te FSHF kur fillohen te tille procedura shperndarje.
3. Komiteti Ekzekutiv i FSHF mund te marre cfaredolloj hapi te nevojshem per te mbeshtetur ate anetar ose mund te detyroje pasuesin e mundshem ligjor te ketij anetari qe te permbushe te gjitha detyrimet financiare te anetarit qe eshte shkeputur.

Neni 17

Raste te vecanta

Statusi i anetarit humbet edhe per arsye te tjera te parashikuara ne ligjin Shqiptar.

Neni 18

Presidenti i Nderit dhe Anetaret e Nderit

1. Me propozimin e KE, Asambleja e Pergjitheshme mundet te jap titullin e presidentit te nderit ose anetarit te nderit cdo personi per merita ne sherbim te futbollit.
2. President nderi mund të jetë vetëm një ish-President. Ai mund të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv apo Asamblenë e Përgjithshme. Ai mund të dikutojë por nuk ka të drejtë vote.
3. Anetari i nderit mundet te marrin pjese ne Asamblene e Pergjitheshme. Ata mundet te diskutojne por nuk kane te drejte vote.

V. ORGANIZATA

Neni 19

Lista e organeve

1. Organet e meposhtem kane statusin e organeve te FSHF-se:
 - a. Organi Legjislativ: Asambleja e Pergjitheshme
 - b. Organi Ekzekutiv: Komiteti ekzekutiv
 - c. Organet Gjykuese:
 - i. Komisioni i Disiplines,
 - ii. Komisioni i Apelit.
 - iii. Dhoma Kombetare e Zgjidhjes se Konflikteve
 - iv. Komisioni i Etikes
 - v. Inspektoret e Disiplines
 - vi. Komisioni i Licensimit te Klubeve
 - vii. Komisioni i Apelit per Licensimin e Klubeve
 - d. Organi Administrativ: Sekretari i Pergjithshem
2. FSHF emerone nje kompani audituese te pavarur qe ka eksperiencen dhe kualifikimin e nevojshem per auditimin e llogarive financiare.
3. FSHF ka Komisionet e Perhershme te meposhtme si trupa konsultues te FSHF nqs nuk eshte vendosur ndryshe nga keto Statute, Rregullave te Prrocedurave te Asamblese se Pergjithshme ose nga termat e references. Keto terma reference percaktojne te drejtat dhe detyrat si dhe objektivat e cdo Komisioni. Keto terma reference aprovohen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF:
 - a. Komisioni i Verifikimit.
 - b. Komisioni i Finances.

- c. Komisioni i Ligës dhe Garave.
 - d. Komisioni i Arbitrimit.
 - e. Komisioni i te Rinjve dhe masivizimit.
 - f. Komisioni i Edukimit dhe Shkences.
 - g. Komisioni i Mjekesise Sportive, Futsallit dhe Futbollit të Rërës
 - h. Komisioni i Infrastruktures Sportive dhe Investimeve.
 - i. Komisioni Juridik dhe i Licensimit
 - j. Komisioni i Ekipeve Kombëtare
 - k. Komisioni i Futbollit të Femrave
 - l. Komisioni i Marrdhënieve me Median, Publikun dhe Marredhenieve Nderkombetare
4. Komitetit Ekzekutiv mund te krijojë komisione te perkohshme te posaçme per detyra specifike ose per nje periudhe kohe te kufizuar. Te drejtat dhe detyrat jane percaktuar ne termat e references te miratuara nga Komiteti Ekzekutiv.

A. Asambleja e Pergjithshme

Neni 20

Percaktimi, perberja dhe Komisioni i Verifikimit

1. Asambleja e Pergjithshme eshte takimi ne te cilin te gjithe anetaret e FSHF-se mblidhen se bashku nje here ne vit, per te marre vendime statutore. Ajo perfaqeson autoritetin me te larte te FSHF.
2. FSHF, mund te therrase nje Asamble te Pergjithshme te zakonshme ose te jashtezakonshme. Vetem nje mbledhje e thirrur sipas rregullave ka autoritetin per te marre vendime.
3. Presidenti i Nderit dhe anetare nderi ftohen ne Asamblene e Pergjithshme me kapacitet konsultues sikurse edhe anetaret e Komitetit Ekzekutiv dhe Sekretari i Pergjithshem i FSHF.
4. Komiteti Ekzekutiv gjithashtu mund te ftojë persona te tjere ne Asamblene e Pergjithshme. Ata nuk kane te drejte votimi dhe mund te konsultohen ose te mbajne fjalim vetem me lejen e Kryetarit te mbledhjes.
5. Asambleja e Pergjithshme e zakonshme dhe e jashtezakonshme eshte e rregulluar nga Rregullat e Procedurave te Asamblese se Pergjithshme te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme

Neni 21

Emerimi i delegateve

1. Anetaret emerojne delegatet e tyre zyrtare te autorizuar per t'i perfaqesuar ata, ne perputhje me Statutet e tyre .
2. Delegatet zyrtare duhet te jene te pajisur me nje prokure ose autorizim të lëshuar nga organi i tyre kompetent.
3. Anetaret jane te detyruar te dergojne listen e emrave te delegateve te tyre ne Sekretariatin e Pergjithshem te FSHF jo me vone se 20 dite para dates se zhvillimit te asamblese.

Neni 22

Numri dhe percaktimi i delegateve

1. Cdo anetar ka te drejten e nje vote dhe nuk mund te perfaqsoje me shume se nje anetar. Perfaqesimi i anetarit ne mbledhjen e asamblese behet nga delegatet. Rregullat e perfaqesimit te delegatit percaktohen sipas dispozitave te Kodit Civil ne fuqi dhe akteve te themelimit te subjektit anetar.

2. Lista e anëtarëve miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF. Ndryshimi i numrit të anëtarëve bëhet sipas rregullave të përcaktuara në statut.

Neni 23

Fushat e autoritetit (kompetencat)

Asambleja e Përgjithshme ka fushat e autoritetit (kompetencat) të mëposhtme:

- a. Adopton ose ndryshon Statutet dhe Rregulloret e miratuara prej saj.
- b. Aprovon proces verbalin e Asamblese së Përgjithshme të fundit.
- c. Aprovon llogarite vjetore të FSHF dhe vendos në caktimin e fitimeve ose leshon deklarata sesi duhen mbuluar humbjet që dalin nga llogaria e fitimeve dhe humbjeve.
- d. Pranon raportin e aktiviteteve të Komitetit Ekzekutiv.
- e. Aprovon pasqyren e llogarive vjetore;
- f. Pranon raportin e auditoreve të pavarur;
- g. Voton për buxhetin e FSHF;
- h. Cakton auditorin e pavarur;
- i. Fikson kuoten e regjistrimit të anëtarëve dhe pagesa të tjera për çdo kategori të anëtarëve;
- j. Zgjedh Presidentin dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv çdo katër vjet;
- k. Zgjedh anëtarët e Komisionit të Verifikimit çdo dy vjet;
- l. Aprovon propozimet e Komitetit Ekzekutiv për të dhënë titullin e Presidentit të Nderit ose për Anëtar Nderi për individë, të cilët kanë dhënë një kontribut vecanerisht të vlefshëm në futboll brenda FSHF.
- m. Pranon, pezullon ose përjashton një anëtar;
- n. Liron nga funksioni një anëtar të një organi ekzekutiv të FSHF-së;
- o. Deklaron shpërberjen e FSHF dhe vendos mbi përdorimin e aseteve të saj financiare.
- p. Aprovon ose ndryshon Rregullat e Procedurave të Asamblese së Përgjithshme; Kodin e Disiplinës; Kodin e Etikës

Neni 24

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Ekzekutiv një herë në vit, në gjashtëmujorin që vijon pas përfundimit të viti financiar. Ftesa për mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme të Zakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve të pakten 30 (tridhjetë) ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Komiteti Ekzekutiv cakton rendin e ditës së Asamblese së Përgjithshme. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, llogarite, buxheti dhe ndonjë dokument tjetër i rëndësishëm duhet t'i dërgohen anëtarëve të pakten 10 (dhjetë) ditë para datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rend të ditës të një çështjeje. Një kërkesë e arsyetuar duhet të paraqitet në sekretariatit të FSHF 20 (njëzetë) ditë para mbledhjes.

Neni 25

Rendi i ditës për Asamble e Përgjithshme të Zakonshme.

1. Rendi i ditës për Asamble e Përgjithshme të Zakonshme duhet të përfshijë të pakten çështjet e mëposhtme:
 - a. Përsëritja nga Presidenti;
 - b. Verifikim i përberjes së mbledhjes si dhe mbledhja në përputhje me rregullat dhe statutet e FSHF-së;
 - c. Caktimi i vezhguesve;

- d. Emerimi i delegateve per te verifikuar procesverbalin;
 - e. Aprovimi i procesverbalit te Asamblese se Pergjithshme te meparshme, (nese e aplikueshme);
 - f. Raporti i Presidentit për aktivitetin e Komitetit Ekzekutiv;
 - g. Aprovimi i raportit te aktiviteve te Komitetit Ekzekutiv;
 - h. Pezullimi ose perjashtimi anetareve (nese eshte e aplikueshme);
 - i. Aprovimi i pasqyres se llogarive per vitin financiar te meparshem;
 - j. Pranimi i raportit te auditorit te pavarur;
 - k. Aprovimi i buxhetit per vitin financiar pasardhes;
 - l. Zgjedhja e Presidentit (per nje Asamble te Pergjithshme zgjedhore);
 - m. Zgjedhja e anetareve te tjere te Komitetit Ekzekutiv (per nje Asamble te Pergjithshme zgjedhore);
 - n. Zgjedhja e anetareve te Komisionit te Verifikimit (per nje Asamble te Pergjithshme zgjedhore);
 - o. Shqyrtimi i propozimeve per ndryshime ne statutet e FSHF.
 - p. Shkarkimi i nje anetari te organit Ekzekutiv te FSHF (nese eshte e aplikueshme)
 - q. Kerkesat nga anetaret e Komitetit Ekzekutiv ose nga anetaret e FSHF.
 - r. Ndonje ceshtje tjeter.
2. Pranimi i anetarit duhet te perfshihet ne rendin e dites pas zhvillimit te gjithe diskutimeve. Ne te kundert, pezullimi apo perjashtimi i nje anetari behet perpara cdo lloj diskutimi.
 3. Rendi i dites mund te modifikohet vetem nese mbeshtetet nga 2/3 e delegateve te pranishem.

Neni 26

Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme

1. Komiteti Ekzekutiv mund te therrase nje Asamble te Pergjithshme te Jashtezakonshme nese e quan te nevojshme.
2. Asambleja e Pergjithshme e jashtezakonshme mund te kerkohet me shkrim nga te pakten nje e treta e anetareve te FSHF. Nje kerkese e tille duhet te behet me shkrim duke parashtruar arsyet dhe duke perfshire rendin e dites qe propozohet. Komiteti Ekzekutiv duhet ta therrase Asamblene e Pergjithshme te jashtezakonshme brenda dy muajve qe nga dita e marrjes se kerkeses. Nese nje mbledhje e tille nuk thirret, anetaret qe e kerkuan mund ta adresojne kete ceshtje te FIFA dhe UEFA per ndjekje nga ana e tyre.
3. Lajmerimi per mbledhjen e jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme duhet t'u dergohet delegateve te pakten 30 dite para dites se mbledhjes.
4. Rendi i dites dhe cdo dokument tjeter i rendesishem duhet t'u dergohet delegateve te pakten 10 dite para dites se mbledhjes.
5. Kur Komiteti Ekzekutiv therret mbledhjen e jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme ai eshte pergjegjes per pergatitjen e rendit te dites.
6. Rendi i dites nuk mund te ndryshohet gjate mbledhjes.

Neni 27

Numri i duhur i votave (Quorum)

1. Asambleja e Pergjithshme (e zakonshme ose e jashtezakonshme) mund te marre vendime te vlefshme vetem kur shumica absolute [50 %+1] e te gjithe anetareve te FSHF perfaqesohet nga delegate te caktuar posacerisht.
2. Nese numri i duhur nuk arrihet, nje Asamble e Pergjithshme e dyte duhet te mbahet 24 ore pas te pares me te njejtin rend dite.

3. Nuk kerkohej shumice per mbledhjen e dyte, pervec rasteve kur ne rendin e dites jane parashikuar :
 - a. Ndryshime te statuteve te FSHF;
 - b. Zgjedhja e presidentit te FSHF;
 - c. Zgjedhja e nje anetari te Komitetit Ekzekutiv te FSHF;
 - d. Shkarkimi nga detyra i nje ose me shume anetareve te nje organi te FSHF;
 - e. Perjashtimi i nje anetari te FSHF ose
 - f. Shperberja e FSHF;
4. Per keto pika te permendura me siper, nevojitet shumica e percaktuar ne paragrafin 1.

Neni 28

Drejtimi i Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme (e zakonshme ose e jashtezakonshme) drejtohet nga Presidenti i FSHF, dhe zhvillohet me mbeshtetjen e Komisionit te Verifikimit ne perputhje me Rregullat e Procedurave te Asamblese se Pergjithshme.
2. Asambleja cakton te pakten tre vezhgues (numerus votash) me propozimin e Kryetarit te mbledhjes.
3. Kryetari eshte pergjegjes per te siguruar qe mbledhja ndjek rendit e dites dhe respekton Rregullat e Procedurave te Asamblese se Pergjithshme. Ne kete aspekt, ai ka te drejte të shkurtoje fjalimet nga delegatet ose te perjashtojte pjesemarres nga dhoma e mbledhjes.
4. Sekretari i Pergjithshem cakton dikë te per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes i cili sipas rregullit firmoset nga Kryetari dhe duhet t'u cohet delegateve brenda 30 diteve qe nga dita e mbledhjes qe ta rishikojne dhe te komentojne brenda 30 diteve.

Neni 29

Marrja e Vendimeve

1. Anetaret e FSHF ushtrojne te drejten e votës nepermjet delegateve te tyre zyrtare.
2. Nese nuk eshte percaktuar ndryshe ne Statute, vendimet jane te vlefshme neqoftese mbeshteten nga nje shumice e thjeshte (dmth 50% plus nje vote) e votave te vlefshme te delegateve te pranishem.
3. Vendimet qe vijojne kane nevojë per mbeshtetjen e te pakten 2/3 te votave te vlefshme te delegateve te pranishem ne Asamblene e Pergjithshme:
 - a. Modifikimi i rendit te dites te Asamblese se Pergjithshme te zakonshme;
 - b. Ndryshime ne Statutet e FSHF;
 - c. Pushimi i nje anetari te organit te FSHF;
 - d. Dhurimi i titullit President Nderi ose Anetar te Nderit i FSHF;
 - e. Perjashtimi i nje anetari te FSHF;
 - f. Shperberja e FSHF.
4. Votat e demtuara, votat e pambushura, ose ndonje forme tjeter abstenimi nuk do te perfshihet ne numerimin e votave.
5. Vendimet duhet te merren duke ngritur doren, pervec rasteve kur 1/3 e delegateve qe jane te pranishem kerkon votim te fshehte.
6. Votimi me prokurë ose me autorizim nuk lejohet.
7. Vendimet e marra nga Asambleja hyjne ne fuqi nje dite pasi ato jane miratuar, me perjashtim te rasteve kur Asambleja vendos ndryshe.

Neni 30

Zgjedhjet

1. Zgjedhjet behen ne menyre te fshehte. Ne qofte se numri i kandidateve eshte i barabarte me numrin vakant, zgjedhjet mund te behen duke ngritur doren.

2. Asambleja e Pergjithshme zgjedh sipas radhes qe vijon dhe me zgjedhje te lira:
 - a. Presidentin e FSHF;
 - b. Anetaret qe mbeten te Komitetit Ekzekutiv;
 - c. Anetaret e Komisionit Verifikues;
3. Gjate zgjedhjes se pare, Presidenti ka nevojte per 2/3 e votave te vlefshme me qellim qe te zgjidhet sipas rregullave. Ne rastet kur asnje nga kandidatet nuk arrin kete shumice, behet nje round i dyte zgjedhjesh midis dy kandidateve qe kane marre me shume vota ne roundin e pare. Ne roundin edyte, kandidati qe merr me shume vota zgjidhet President. Ne rastet e votave te barabarta, votimi do te perseritet. Neqoftese edhe votimi I dyte perfundon me rezultat te barabarte, vendimi merret nepermjet hedhjes se shortit nga Sekretari i Pergjithshem dhe monitoruar nga Komisioni i Verifikimit.
4. Zgjedhja e anetareve te mbetur te Komitetit Ekzekutiv dhe anetaret e Komisionit te Verifikimit letra e zgjedhjeve konsiston ne nje liste te te gjitha kandidateve (ne rend alfabetik). Kandidati zgjidhet ne roundin e pare nese mbeshtetet nga nje shumice absolute e votave te vlefshme (p.sh 50% + nje vote). Ne qofte se nuk ka kandidate te mjaftueshem qe arrijne nje shumice absolute per te mbushur vendet bosh, organizohet raundi i dyte per te cilin nje shumice e thjeshte (me te shumtat e votave) mjafton per nje kandidat qe te zgjidhet. Ne rast barazimi behet raundi i trete per te cilin mjafton nje shumice e thjeshte. Ne rastin e nje barazimi te metejshe, rezultati i zgjedhjeve percaktohet nepermjet hedhjes se shortit nga Sekretari i Pergjithshem.

B. Komiteti Ekzekutiv

Neni 31

Perberja

1. Komiteti Ekzekutiv perbehet nga 11 anetare:
 - a. Presidenti
 - b. Tetë anetare të zgjedhur nga Asambleja nga të cilët të paktë një femër.
2. Presidenti i zgjedhur i Bashkimit të Arbitrave Shqiptar të Futbollit dhe Ligës Profesioniste të Futbollit janë në te njejten kohe automatikisht dhe anetar i Komitetit Ekzekutiv te FSHF.
3. Me zgjedhjen nga Asambleja e Përgjithshme, çdo anëtar i Komitetit Ekzekutiv zotohet të veprojë me mirëbesim, besnikëri dhe pavarësi në interes të FSHF dhe promovimit e zhvillimit të futbollit.
4. Nje anetar I FSHF mund te propozoje vetem nje kandidat per president ose nje kandidat per vendet e mbetura ne Komitetin Ekzekutiv.
5. Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme:
 - a. Te jete shtetas shqiptar dhe te banoje ne Shqiperi;
 - b. Te mos jete i denuar penalisht për krime ose kundërvajtje penale ~~per krim te rende;~~
 - c. Te leshoje nje deklarate me shkrim se ai jep doreheqjen nga funksionet brenda anetaresise se FSHF nese zgjidhet;
 - d. Te jete nën moshen 70 vjeç ne daten qe mbahet Asambleja e Pergjithshme zgjedhore;
 - e. Kushte te tjera ne lidhje me shkollimin apo kualifikimin e nevojshem jane te percaktuara ne termat e references korresponduese te miratuara nga Komiteti Ekzekutiv.
6. Anetaret e pezulluar nuk mund te propozojne ndonje kandidat per zgjedhje.
7. Anetaret duhet te dergojne emrat e kandidateve bashke me kurrikulumin e tyre ne Sekretariatin e Pergjithshem te FSHF I cili i dergon ato tek Komisioni i Verifikimit per

vlersim dhe aprovim. Lista e kandidateve te aprovuar duhet t'u dergohet kandidateve bashke me rendin e dites se Asamblese.

8. Ne mbledhjen e tyre te pare, anetaret e zgjedhur te Komitetit Ekzekutiv zgjedhin midis tyre zevendes presidentin e pare dhe te dyte. Presidenti mund te shprehe propozimet e tij.
9. Nje anetar i Komitetit Ekzekutiv nuk mund te jete njekohesisht edhe anetar i nje organi juridik te FSHF.

Neni 32

Kohezgjatja e mandateve

1. Anetaret e Komitetit Ekzekutiv (perfshire dhe presidentin) sherbejne nje mandat kater vjecar dhe ata mund te rizgjidhen;
2. Ne qofte se nje nga vendet e tyre mbetet bosh, Komiteti Ekzekutiv duhet ta plotesoje ate brenda 30 ditesh, per periudhen qe mbetet deri ne mbledhjen e radhes te Asamblese se Pergjithshme te zakonshme ku zgjidhet nje zevendesues per kohen e mbetur te mandatit.
3. Nëse një nga vendet e tyre mbetet bosh gjatë vitit të fundit të mandatit, asnjë ndryshim nuk do të kryhet.
4. Anetaret e FSHF mund te propozojne kandidate per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te zakonshme te radhes ne perputhje me Nenin 28. Zevendesuesit emeruar nga Komiteti Ekzekutiv jane automatikisht kandidate per keto zgjedhje.

Neni 33

Mbledhjet

1. Komiteti Ekzekutiv mblidhet sipas kerkesave, por te pakten gjashte here ne vit.
2. Mbledhjet drejtohen nga Presidenti.
3. Presidenti therret mbledhjen te pakten dhjete dite perpara zhvillimit te mbledhjes.
4. Me kerkesen e te pakten kater anetare te KE, Presidenti duhet te therrase mbledhjen brenda tre javeve pas marrjes se kerkeses dhe nese Presidenti nuk e therret mbledhjen, atehere nje nga anetaret qe ka kerkuar takimin ka te drejte ta beje kete vete.
5. Anetaret duhet te propozojne ~~tema~~ çështje për rendin e ditës së mbledhjes tek Sekretari i Pergjithshem te pakten tete dite perpara takimit. Rendi i dites perfundimtar dhe dokumentet perkatese duhet te dergohen tek anetaret e Komitetit Ekzekutiv te pakten pese dite para mbledhjes.
6. Sekretari i Pergjithshem merr pjese ne takimet e Komitetit Ekzekutiv vetem si konsultues.
7. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv nuk mbahen ne publik. Megjithate Komiteti Ekzekutiv mund te ftoje pale te treta te marrin pjese. Keto pale te treta nuk kane te drejte votimi dhe mund te shprehin opinionin e tyre vetem me lejen e Presidentit te FSHF.

Neni 34

Kompetencat

1. Komiteti Ekzekutiv ka autoritet ne fushat e vecanta te meposhtme:
 - a. Menaxhon dhe drejton punet e FSHF-se ne perputhje me keto Statute dhe siguron zbatimin e Statuteve te FSHF-se. Komiteti Ekzekutiv mund të aprovojë dispozitat e nevojshme per aplikimet e tyre.
 - b. Me propozim te Presidentit, emerone dhe shkarkone Sekretarin e Pergjithshem.
 - c. Me propozim te Sekretarit të Pergjithshem emerone dhe shkarkone shefat e sektoreve te Sekretariatit te Pergjithshem te FSHF.

- d. Me propozim te Sekretarit te Pergjithshem te permiresoje rregulloren e brendshme organizative te Sekretariatit te Pergjithshem te FSHF.
 - e. Te zgjedhe midis anetareve te tij zevendes Presidentin e pare dhe te dyte.
 - f. Te emeruje, pezulloje ose shkarkojë anetarë te organeve gjyqesore te FSHF.
 - g. Të përgatisë dhe te mbaje Asamblene e Pergjithshme te zakonshme dhe te jashtezakonshme.
 - h. Te rishikojë pasqyren e llogarive dhe te hartojë buxhetet.
 - i. Te aprovoje kontratat me shkrim per secilin trainer dhe anetar te stafit teknik te ekipeve kombetare te ndryshme. (Ndoshta duhet rishikuar ose ehqur)
 - j. Te hartojë raportin per aktivitetet.
 - k. Te pezulloje me efekt te menjehershme nje anetar te Komitetit Ekzekutiv ose te nje organi juridik ne rastet kur shkel hapur ose ne menyre te perseritur ndonje nga dispozitat e kuadrit ligjor te FSHF, apo per arsye te tjera te rendesishme qe demtojne imazhin dhe reputacionin e FSHF.(p.sh kryerja e nje vepre penale, etj)
 - l. Te emeruje, te pezulloje ose te shkarkojë anetarët e Komiteteve te perhershem ose te perkohshme.
 - m. Te pergatise rregulloret qe do te adoptohen ose ndryshohen nga Asambleja e Pergjithshme.
 - n. Te miratoje, ose ndryshoje rregulloren e FSHF qe eshte nen kompetencat e saj si dhe termat e references te organeve dhe Komisioneve te FSHF.
 - o. Te lejoje fonde per shpenzime te paparashikuara ne buxhet qe nuk e kalon masen e 10% te buxhetit vjetor te FSHF qe eshte aprovuar ne mbledhjen me te fundit te Asamblese se Pergjithshme.
 - p. Te krijojë, organizojë dhe te anullojë garat zyrtare ne nivel kombetar si dhe te hartoj rregulloret e duhura per gara.
 - q. Te ushtroje te drejten per te propozuar perfaqesuesit e FSHF per zgjedhje ne organe te ndryshme kombetare dhe nderkombetare.
 - r. Te propozojë kandidatë te pershtatshem titullin President Nderi ose Anetar Nderi i FSHF.
 - s. Te aprovoje statutet dhe rregulloret lojës si dhe ndryshimet perkatese.
2. Gjithashtu Komiteti Ekzekutiv ushtron ato autoritete te cilat nuk i jane caktuar ndonje organi tjetër te FSHF.
 3. Me miratimin e tij, Komiteti Ekzekutiv mund t'i delegojë detyrat e tij qe jane jashte fushes se vet te kompetencave me shkrim dhe te kerkojë sherbimet e keshilltareve ose ti jape mandate paleve te treta.

Neni 35

Vendim-marrjet

1. Komiteti Ekzekutiv ka nevojë per nje numer te caktuar prej te pakten gjashte anetaresh ne menyre qe te marre vendime te vlefshme.
2. Vendimi merret ne qofte se mbeshtetet te pakten nga shumice absolute (50%+1 vote) te anetareve te pranishem. Ne rastin e votave te barabarta, Presidenti ka vote vendimtare. Anetarët qe mungojne nuk mund te votojne.Votimi ne emer te anetarit qe mungon eshte i ndaluar.
3. Cdo anetar i Komitetit Ekzekutiv duhet te abstenojë automatikisht nga diskutimi dhe votimi nese ka rrezik ose mundesi per konflikt interesash.
4. Vendimet e marra regjistrohen ne procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv hyjne ne fuqi menjehere, pervec rasteve kur Komiteti Ekzekutiv vendos ndryshe.

6. Per ceshkje qe kerkojne zgjidhje te menjehershme midis dy mbledhjeve te Komitetit Ekzekutiv, Presidenti me dy zevendes presidentet marrin nje vendim, i cili duhet te ratifikohet ne mbledhjen e radhes te Komitetit Ekzekutiv.

Neni 36
Presidenti

1. Presidenti eshte perfaqesuesi ligjor i FSHF.
2. Detyrat e Presidentit jane si me poshte:
 - a. Mbledh Asamblene e Pergjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv;
 - b. Drejton Asamblene e Pergjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv;
 - c. Mbikqyr zbatimin e vendimeve te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme dhe Komiteti Ekzekutiv;
 - d. Siguron funksionimin e rregullt dhe efektiv te organeve dhe trupave te FSHF, ne menyre qe te arrihen objektivat e percaktuara nga keto Statute dhe/ose te fiksuara nga Komiteti Ekzekutiv;
 - e. Mban lidhjet midis FSHF dhe anetareve te tij, FIFA dhe UEFA, me organizmat politike dhe organizata te tjera;
 - f. Mbikqyr funksionimin e Sekretariatit te Pergjithshem.
 - g. Te emeruje trajneret dhe stafet teknike te ekipeve kombetare pasi eshte konsultuar me anetaret e Komitetit Ekzekutiv.
3. Ne rast kur Presidenti mungon, detyrat e tij plotesohen nga Zevendes-Presidenti i Pare. Ne rast se edhe ky i fundit mungon, atehere pergjegjesine e merr Zevendes-Presidenti i Dyte.
4. Ne rastet kur Presidenti jep doreheqjen gjate mandatit te tij, Komiteti Ekzekutiv zgjedh nje nga anetaret e tij te kryeje funksionin e Presidentit te perkohshem. Komiteti Ekzekutiv mund te therrase Asamblene e Pergjithshme te jashtezakonshme per te zgjedhur nje President te ri per kohen e mbetur nga mandati. Nese Asambleja e Pergjithshme e radhes mbahet brenda gjashte muajve atehere nuk mblidhet Asambleja e Pergjithshme e jashtezakonshme dhe Zevendes-Presidenti i Pare merr funksionet e Presidentit.

Neni 37
E drejta e firmosjes

Presidenti dhe Sekretari i Pergjithshem ose njeri nga zevendes presidentet dhe Sekretari i Pergjithshem mund te firmosin se bashku ne emer te FSHF pervec rasteve ku eshte vendosur ndryshe ne rregulloret e brendshme organizative te Sekretariatit te Pergjithshem te FSHF.

C. Organet e kontrollit financiar.

Neni 38
Kontrollues te pavarur

1. Audituesi i pavarur i FSHF auditon pasqyren e llogarive te rishikuara nga Komisioni i Finances dhe Komiteti Ekzekutiv i FSHF ne perputhje me parimet e kontabilitetit dhe legjislacionit kombetar.
2. Raporti i auditimit i kalohet Komitetit Ekzekutiv dhe pa ndryshime duhet t'i kaloje edhe Asamblese se Pergjithshme per miratim.
3. Audituesi i pavarur duhet te jete nje kompani e njohur dhe me reputacion. Ai emerohet me mandat vjetor te rinovueshem nga Asambleja e Pergjithshme e FSHF-se me propozim te Komitetit Ekzekutiv te FSHF-se.

D. Organet gjyqesore

Neni 39

Dispozita te pergjithshme

1. Organet gjyqesore juridike perbehen nga trupa disiplinore dhe trupa per licensimin e klubeve.
2. Organet gjyqesore te FSHF jane:
 - a. Komisioni i Disiplines;
 - b. Komisioni i Apelit;
 - c. Dhoma e Zgjidhjes se Konflikteve
 - d. Komisioni i Etikes
 - e. Inspektoret e Disiplines.
3. Kompetencat dhe funksionimi i trupave gjyqesore jane te percaktuara respektivisht ne Kodin e Disiplines, Rregulloren e Dhomes Kombetare te Zgjidhjes se Konflikteve dhe Kodin e Etikes se FSHF te cilat miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.
4. Organet e licensimit te Klubeve te FSHFs jane:
 - a. Komisioni i Licensimit te Klubeve
 - b. Komisioni i Apelit per Licensimin e Klubeve
5. Pergjegjesite e tyre dhe funksionet e trupave per licensimin e klubeve jane percaktuar ne Rregulloret e Licensimit te Klubeve si dhe ne termat korresponduese te references te dyja te aprovuara nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF.
6. Te gjithe anetaret e ketyre organeve gjyqesore juridike , pervec Komisionit te Etikes , emerohen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF per nje mandat kater vjecar dhe duhet te pajtohen me kerkesat e rregulloreve perkatese. Ata duhet automatikisht te abstenojne nga emerimi nese do te kete nje konflikt interesi. Ne rast mosmarreshjesh per kete konflikt interesi, vendimin perfundimtar e merr Presidenti i Komisionit perkatese..
7. Organet Juridike mund te japin sanksione sic jane te percaktuara ne rregulloret e aplikueshme. (Rregulloret e Disiplines ose Rregulloret e Licensimit te klubeve)
8. Keto masa ne lidhje me pezullimin dhe perjashtimin e anetareve jane subjekt i pushtetit disiplinor te Asamblese se Pergjithshme dhe KE te FSHF-se.

Neni 40

Pavaresia dhe Abstenimi

1. Organet gjyqesore jane te pavarura. Asnje anetar nuk mund te jete ne te njejten kohe anetar i ndonje organi tjeter te FSHF.
2. Anetaret e tyre kufizohen nga Statutet dhe Rregulloret e FSHF si dhe nga legjislacioni kombetar ne fuqi.
3. Nje anetar i organit gjyqesor duhet te abstenoje automatikisht ne rastet kur ekziston ose mund te ndodhe nje konflikt interesi. Ne rast dyshimi, Kryetari i Organit merr vendimin perfundimtar.

Neni 41

Komisioni i Disiplines

1. Komisioni i Disiplines shqyrton dhe ndeshkon cdo shkelje te statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve te FSHF, si dhe cdo shkelje te Ligeve te Lojes dhe sjelljet antisportive te cilat nuk jane nen juridiksionin e ndonje organi tjeter te FSHF.
2. Komisioni i Disiplines perbehet nga nje Kryetar, nje nen kryetar dhe 8 anetare. Kryetari, nenkryetari dhe te pakten 5 nga anetaret duhet te jene juriste me pervoje.
3. Pervec se kur parashikohet ndryshe, cdo ceshtje shqyrtohet nga nje trup gjyqes i perbere nga tre anetare, nga te cilet te pakten dy duhet te jene juriste dhe qe jane

emeruar sipas rregullave nga Presidenti i Komisionit te Disiplines. Kryetari i cdo trupi gjykues qe shqyrton nje ceshtje si gjyqtar i vetëm emerohet nga Presidenti i Komisionit te Disiplines dhe ne cdo rast duhet te jete jurist. Ne rastet kur Presidenti eshte anetar i trupit gjykues ai ushtron kompetencat e kryetarit te trupit gjykues.

4. Ne mungese te Kryetarit Presidentit te Komisionit te Disiplines, ose ne rastet e ndonje konflikti te mundshem interesi te tij, ai abstenon dhe zevendesohet nga nën kryetari Zv/Presidenti i Komisionit te Disiplines, i cili vendos perfundimisht nese Presidenti ka nje konflikt interesi.
5. Rregullat e mëtejshme të veprimit përpara Komisionit të Disiplinës dhe Komisionit të Apelit, përcaktohen në Kodin e Disiplinës Sportive.

Neni 42

Komisioni i Apelit

1. Komisioni i Apelit shqyrton apelimet e depozituara kunder vendimeve te marra nga Komisioni i Disiplines.
2. Komisioni i Apelit perbehet nga nje Kryetar, nje Nën kryetar 3 anetarë të tjerë. Presidenti, Zv/Presidenti dhe te gjithë anetaret duhet te jene juriste me pervoje me formim juridik.
3. Si rregull, Komisioni i Apelit merr vendime në prani të të gjithë anëtarëve, por ka të drejtë të marrë vendime nëse janë prezent të paktën tre anëtarë;
4. Ne mungese te Presidentit te Komisionit te Apelit, ose ne rastet e ndonje konflikti te mundshem interesi te tij, ai abstenon dhe zevendesohet nga Zv/Presidenti Komisionit te Apelit, i cili vendos perfundimisht nese Presidenti ka nje konflikt interesi.

Neni 42/1

Dhoma e Zgjidhjes se Konflikteve

1. Dhoma e Zgjidhjes se Konflikteve eshte pergjegjese per trajtimin e konflikteve midis klubeve dhe lojtareve/trajnerëve në lidhje me ceshtjet e punesimit dhe qendrueshmerine kontraktuale si dhe persa i perket shperblimit te trajningut (formimit) të lojtareve dhe kontributeve solidare ndermjet klubeve anetare te FSHF-se ose pjesmarrëse në aktivitetet e organizuara nga FSHF.
2. Dhoma e zgjidhjes se Konflikteve perbehet nga nje Kryetar, dy Nënkryetar dhe 10 anetare te cilet duhet te jene juriste me pervoje. Pese nga anetaret emerohen nga perfaqesuesit e klubeve dhe pese te tjeret nga perfaqesuesit e lojtareve/trajnerëve. Presidenti dhe Zv/ Presidentet zgjidhen nga perfaqesuesit e klubeve dhe lojtareve, bazuar ne pese kandidaturat e propozuara nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se.
3. Kryetari i cdo trupi gjykues emerohet nga Presidenti i Dhomes se Zgjidhjes se Konflikteve dhe ne cdo rast duhet te jete gjykates me pervoje. Ne rastet kur Presidenti eshte anetar i trupit gjykues, ai ushtron kompetencat e kryetarit.
4. Rregullat dhe modalitetet e funksionimit te Dhomes se Zgjidhjes se Konflikteve percaktohen ne Rregulloren e Dhomes se Zgjidhjes se Konflikteve qe miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF.
5. Ne mungese te Presidentit, ose ne rastin e nje konflikti interesi, ai zevendesohet nga Zv/Presidenti i Dhomes se Zgjidhjes se Konflikteve qe ka me shume vite pune, i cili vendos perfundimisht per konfliktin e interesit te Presidentit. Nese i njeiti rast ndodh per Zv/Presidentin qe ka me shume vite pune, atehere Zv/Presidenti tjetër ushtron perkatesisht kompetencat e Presidentit.
6. Vendimet e marra nga Dhoma e Zgjidhjes se Konflikteve, mund te jene subjekt i ankimit perpara nje organi arbitrazhi te njohur nga FIFA, i cili duhet te jete subjekt i nje marreveshje ndermjet FSHF dhe FIFPro.

7. Afati limit i ankimit prej 21 ditësh duhet të fillojë në ditën kur është njoftuar zyrtarisht vendimi i Dhomes së Zgjidhjes së Konfliktëve.

Neni 42/2

Komisioni i Etikes

1. Komisioni i Etikes ka për objekt gjykimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e integritetit dhe reputacionit të Futbollit Shqiptar. Komisioni i Etikes ka juridiksion mbi çdo zyrtar të FSHF-së, të anëtarëve të sajë duke përfshirë por pa u kufizuar tek anëtarët e organeve drejtuese të klubeve, arbitrat dhe asistentët, lojtarët dhe trajnerët, ndihmesit dhe çdo person tjetër përgjegjës për çështjet teknike, mjekesore dhe administrative të FSHF dhe klubeve pjesëmarrëse në veprimtaritë e organizuara prej saj.
2. Komisioni i Etikes përbehet nga një Kryetar, një nënkryetar dhe 3 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 4 (katër) vjeçar.
3. Komisioni i Etikes mund të shpallë secilin prej masave disiplinore të percaktuara në Statut ose në Kodin e Disiplinës së FSHF me kushtin që të jenë të lidhura me objektin e veprimtarisë së këtij komisioni.
4. Të gjitha rregullat organizative dhe procedurale të Kodit të Disiplinës së FSHF aplikohen direkt në kontekstin e të gjitha procedimeve të kryera nga Komisioni i Etikes, me përjashtim të rasteve kur Kodi i Etikes përmban rregulla të kundërta ose kur dispozitat e Kodit të Disiplinës së FSHF dukshëm nuk mund të aplikohen në respektim të objektivave dhe përmbajtjes së Kodit të Etikes.
5. Rregullat dhe modalitetet e funksionimit të Komisionit të Etikes përcaktohen në Kodin e Etikes që miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 43

Inspektoret e Disiplinës

1. Inspektoret e Disiplinës kanë për detyrë të kryejnë hetimet e nevojshme mbi çështjet që i ngarkohen nga çdo organ statutor i FSHF-së.
2. Inspektoret e Disiplinës emerohen me vendim të Komitetit Ekzekutiv për një mandat dy vjeçar.
3. Inspektori i Disiplinës, me Presidentin e Komisionit të Disiplinës emeron një Inspektor Disipline për çdo çështje që perpunon dhe me pas dorëzon një raport tek Komisioni i Disiplinës, i cili merr vendimet përkatëse.
4. Inspektoret e Disiplinës janë juriste të kualifikuara dhe funksionet e tyre janë të percaktuara në Kodin e Drejtësisë Sportive të FSHF-së.
5. Secili nga Inspektoret e Disiplinës duhet të përgatisë një raport vjetor mbi veprimtarinë e tij, i cili i paraqitet Komitetit Ekzekutiv

Neni 44

Lista e masave disiplinore

1. Organet juridike mund të vendosin masat disiplinore sikurse vijojnë me poshtë të cilat edhe mund të kombinohen:
2. Në lidhje me personat individët dhe personat juridik:
 - a. paralajmërim
 - b. qortim (verejtje e rende)
 - c. gjobe
 - d. heqja e një titulli ose cmimi

3. Ne lidhje me individet:
 - a. Nje pezullim per një numer te caktuar ndeshjesh ose per nje periudhe te caktuar kohe
 - b. Pezullim nga kryerja e nje funksioni per numer te caktuar ndeshjesh ose per nje periudhe te caktuar kohe;
 - c. Nje ndalim hyrje ne dhomat e xhveshjes dhe/ose ne stolin e rezervave
 - d. Nje ndalim per te hyre ne stadium;
 - e. Nje ndalim per te marre pjese ne cfaredo lloj aktiviteti futbollistik.
 - f. Shërbimi i futbollit në komunitet.
4. Ne lidhje me personat juridik
 - a. Anullimin e rezultatit te nje ndeshje;
 - b. Urdher qe nje ndeshje duhet luajtur me dyer te mbyllura;
 - c. Zhvillimin e ndeshjeve në fushë asnjane;
 - d. Ndalimin e zhvillimit të ndeshjeve në një stadium të caktuar;
 - e. Ndalimin e transferimit të lojtarëve;
 - f. Zbritjen;
 - g. Zbritje ne nje kategori me te ulet.
 - h. Heqja e licences.

E. Sekretariati i pergjithshem

Neni 45

Detyrat

1. Sekretariati i Pergjithshem eshte organi administrativ i perhershem i FSHF.
2. Detyrat e tij te vecanta jane:
 - a. Te vere ne zbatim vendimet e organeve te FSHF dhe gjithashtu edhe vendimet e Komisioneve te Perhershem ne qofte se specifikohet ne termat korresponduese te references.
 - b. Te drejtoje ceshtjet administrative te FSHF dhe te mbeshtese anetaret e tij ne ket aspekt.
 - c. Te drejtoje ceshtjet administrative ~~ish~~ per garat kryesore te organizuara nga FSHF.
 - d. Te beje pregatitjet per Asamblene e Pergjithshme dhe per mbledhjet e organeve te tjera dhe Komiteteve.
 - e. Te mbaje protokollin e Asamblese se Pergjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv.
 - f. Te kujdeset per korrespondencen e FSHF.
 - g. Te rinovojte listen e anetareve te FSHF dhe te zyrtareve te tyre.
 - h. Te mbaje librat e llogarise se FSHF.
3. Sekretariati i Pergjithshem nxjerr publikimin zyrtar te FSHF, gazeten e FSHF si dhe faqen e saj te internetit.

Neni 46

Sekretari i Pergjithshem

1. Sekretari i Pergjithshem eshte drejtues me pergjegjesi te plote per Sekretariatit te Pergjithshem.
2. Ai emerohet nga Komiteti Ekzekutiv ne baze e nje kontrate punesimi dhe ne perputhje me profilin dhe kerkesat te rena dakort nga Komiteti Ekzekutiv. Komiteti Ekzekutiv gjithashtu shkarkon Sekretarin e Pergjithshem
3. Ai eshte pergjegjes per mbarevajtjen e funksionimit e Sekretariatit te Pergjithshem ne perputhje me rregulloret e brendshme te organizates.

4. Ai puneson dhe pushon nga detyra anetaret e stafit te sekretariatit dhe propozon per emerimin dhe shkarkimin e shefave te sektoreve te Sekretariatit te Pergjithshem te FSHF.
5. Ai merr pjese ne Asamblene e Pergjithshme, takimet e Komitetit Ekzekutiv dhe Komiteteve te qendrueshme dhe te posacme si konsultues.
6. Ne mungesen e e tij, ai cakton nje zevendesues nga Sekretariati i Pergjithshem.

VI. FINANCA

Neni 47

Periudha financiare

Viti financiar i FSHF-se fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti

Neni 48

Te ardhurat

Te ardhurat e FSHF sigurohen vecanerisht nga:

- a. regjistrimet vjetore te anetareve dhe kuotat;
- b. te ardhurat e krijuara nga marketingu i te drejtave qe gezon FSHF;
- c. gjobat e vena nga organet e autorizuar te FSHF. Gjobat e vëna nga organet e autorizuar të FSHF do të shkojnë për investime tek anëtarët dhe/ose projekte sociale.
- d. sponsorizimet, donacionet, kontribute, financimet nga shteti dhe
- e. burime te tjera te ligjeshme.

Neni 49

Shpenzimet

FSHF ka:

- a. Shpenzimet sipas buxhetit te aprovuar ne Asamblene e Pergjithshme.
- b. Shpenzime te tjera qe jane aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme dhe ato qe Komiteti Ekzekutiv ka te drejte te shpenzoje brenda kompetencave te tij.
- c. Shpenzime te tjera per t'ju permbajtur objektivave qe ka FSHF.

Neni 50

Parimet e llogarise

1. Llogarite duhet te mbahen ne perputhje me ligjet e kontabilitetit dhe Legjislacionin Shqiptar.
2. Te ardhurat dhe shpenzimet e FSHF-se duhet te menaxhohen ne menyre te tille qe ato te jene te balancuara gjate vitit financiar. Detyrat kryesore te FSHF ne te ardhmen duhet te jene te siguruara me krijimin e rezervave buxhetore.
3. Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes per perpilimin e llogarive te konsoliduara vjetore te FSHF me shtesat e saj deri me 31 Dhjetor.

VII. GARAT DHE PJESMARRJA NE AKTIVITET

Neni 51

Organizimi i ndeshjeve

1. FSHF zhvillon veprimtarine futbollistike ne Republiken e Shqiperise nepermjet organizimit te garave me shtrirje kombetare, rajonale apo lokale. Struktura e garave

ndertohet gjithashtu ne perputhje me cilesine sportive, gjinine, moshen, llojin e futbollit dhe statusin e lojtarëve.

2. Gara me shtrirje kombetare jane::
 - i. Kampionati Kombetar i Kategorise Superiore
 - ii. Kupa e Shqiperise
 - iii. Superkupa e Shqiperise
 - iv. Kampionati Kombetar i Kategorise se Pare
 - v. Kampionati Kombetar i Kategorise se Dyte
 - vi. Kampionati Kombetar i kategorise se Trete
 - vii. Kampionati Kombetar U19 Superiore
 - viii. Kampionati Kombetar U19 Kategoria e Pare
 - ix. Kampionati Kombetar U17 Superiore
 - x. Kampionati Kombetar U17 Kategoria e Pare
 - xi. Kampionati Kombetar i Femrave
 - xii. Kupa e Shqiperise per Femra
 - xiii. Kampionati Kombetar i Futsal
 - xiv. Kupa e Shqiperise per Futsal
 - xv. Kampionati Kombetar i Futbollit te Reres
3. Gara me shtrirje rajonale jane kampionatet per te rinj sipas vendimeve përkatëse të Komitetit Ekzekutiv
4. Gara me shtrirje lokale jane:
 - a. Kampionatet e shkollave 9-vjecare, te mesme dhe universiteteve per futbollin 11x11;
 - b. Kampionatet e shkollave te mesme per futsal;
5. Komiteti Ekzekutiv i FSHF mund te shtoje edhe gara qe nuk perfshihen ne garat e permendura ne pikat 2, 3 dhe 4 me siper, si dhe mund te vendose pezullimin e perkohshem te nje apo me shume garave nga ato.
6. Komiteti Ekzekutiv i FSHF miraton rregulloret dhe datat e fillimit dhe mbarimit te garave.
7. Cdo subjekt i interesuar te organizoje nje apo me shume ndeshje jashte kalendarit te garave te miratuar nga FSHF apo veprimtari te vecanta futbollit ne Shqiperi duhet me pare te marre leje nga FSHF per kete qellim.
8. Komiteti Ekzekutiv i FSHF ka kompetencen t'i delegoje dhe t'i heqe një lige apo subjekti të caktuar te drejten e organizimit te nje apo me shume garave futbollit. Ne kete rast liga apo subjekti duhet te permbushin te gjitha kushtet qe parashtron kuadri ligjor i FSHF, FIFA dhe UEFA per kete qellim. Ndeshjet miqesore midis klubeve te anetareve te ndryshem te FSHF ne territorin e Shoqates kombetare kane nevojte te miratohen nga FSHF sikurse edhe ndeshjet me klubet e huaja ne territorin e FSHF.
9. Ndeshjet nderkombetare jashte Shqiperise jane subjekt i aprovimit nga federata kombetare perkatese dhe/ose organet drejtuese nderkombetare te FIFA dhe UEFA.
10. FSHF dhe anetaret e saj nuk duhet te luajne ndeshje ose te realizojne takime sportive me shoqatat qe nuk jane anetare te FIFA-s ose UEFA-s apo me anetare provizore te UEFA-s pa miratimin me pare nga FIFA.

Neni 52

Pjesemarrja e klubeve ne gara

1. Ne garat e organizuara nga FSHF mund te marrin pjese vetem ekipe perfaqesues te klubeve anetare te FSHF ose te subjekteve qe jane anetare te nje anetari te FSHF.
2. Pjesemarrja e nje ekipi ne nje gare te organizuar nga FSHF behet vetem pasi klubi ose subjekti qe ai perfaqeson te jete pajisur me licensen perkatese leshuar nga Komisioni i Licensimit ne perputhje me rregulloret perkatese.

3. Perzgjedhja e klubeve Shqiptare ne veprimtarite e organizuara nga UEFA behet ne baze te rezultateve sportive te tij dhe eshte subjekt i plotesimit te kerkesave qe vendos UEFA per pjesemarrje ne ato veprimtari.

Neni 53

Integriteti sportiv i kompeticioneve kombetare, ngjitja dhe renia nga kategoria, si dhe bashkepronësia.

1. Nje klub anetar i FSHF-se mund te marre pjese ne kampionatin kombetar bazuar ne meritat e tij sportive. Nje klub i tille duhet te kualifikohet per kampionatin kombetar duke qendruar ne nje kategori te caktuar ose duke u ngjitur ose rene ne nje kategori tjetër ne fund te sezonit.
2. Përveçse kualifikimit ne baze te meritave, pjesemarrja e nje klubi anetar i FSHF-se ne kampionatin kombetar eshte subjekt i kriterëve te tjera brenda rregullores se licensimit apo ndonje mase tjetër te parashikuar nga FIFA, UEFA, apo FSHF-ja.
3. Ndryshimi i formes ligjore ose structures se kompanise per te lehtesuar kualifikimin per meritat sportive dhe marrjen e licenses per kampionatin kombetar, ne dem te integritetit te kompeticioneve sportive, eshte e ndaluar. Kjo perfshin p.sh. ndryshimi i zyrave, ndryshimi i emrit ose transferimi i aksioneve ndermjet klubeve.
4. Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se adapton rregullat ne menyre qe te promovojë principet e ngjitjes dhe renies nga kategoria dhe per te ndaluar shoqerite komerciale, personat privat, dhe cdo entitet tjetër ligjor qe te kete kontroll mbi me shume se nje anetar te FSHF-se gjithashtu dhe te adaptojë masa te nevojshme per integritetin dhe mbrojtjen e kompeticioneve te FSHF-se.

Neni 54

Lojtaret, trajneret, doktoret, fizioterapistet, arbitrate, delegatet e ndeshjeve, agjente ndeshjes se FIFA dhe UEFA, agjent lojtaresh dhe zyrtare klubesh.

1. Lojtaret, trajneret, doktoret, fizioterapistet, arbitrat, delegatet e ndeshjeve, agjentet e ndeshjeve te FIFA dhe UEFA, agjent lojtaresh dhe zyrtare klubesh, te cilet permbushin nje nga kushtet e meposhtme duhet te regjistrohen ne FSHF:
 - a. ka residence ne territorin e Shqiperise
 - b. ka nje marreveshje kontraktuale me nje nga klubet anetare te FSHF-se
 - c. kryen detyra ne lidhje me ndeshje futbollit ne territorin e Shqiperise
2. Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se adapton Rregulloret perkatese qe drejtojnë Statusin dhe Transferimin e lojtareve si dhe regjistrimin e njerezve te perfshire ne futboll, te cilat percajtojnë kerkesat dhe procedurat per regjistrimin.
3. Rregullat e FSHF-se duhet te perputhen me rregullat e FIFA-s ne lidhje me statusin dhe transferimin e lojtareve.

Neni 55

E drejta e transmetimit, Reklammat dhe Sponsorizimet

1. FSHF dhe anëtarët e tij janë pronaret origjinale te te gjitha te drejtave qe dalin nga garat dhe ngjarje te tjera qe vijne nga juridiksioni respektiv i tyre. Keto te drejta perfshijne, midis te tjerash, cdo lloj te drejte financiare, audiovizuale dhe regjistrimin ne radio, te drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, te drejtat e multimedias, te drejtat e marketingut dhe reklamave dhe te drejtat per jo-materiale si emblemat dhe te drejtat qe dalin mbi bazen e ligjit shqiptar per të drejten e autorit.
2. FSHF, si organizatore e veprimtarive futbollistike në Republikën e Shqipërisë, është pronare e të drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie, duke pasur të drejtën ta shesë atë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Marrëdhëniet juridiko-civile me operatorët televizivë përcaktohen në kontratat e veçanta që lidhen ndërmjet palëve, të hartuara në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi që rregullojnë këto çështje.
4. FSHF gëzon të drejtën e regjistrimit dhe shfrytëzimit të të drejtave që rrjedhin nga komercializimi i emblemës së FSHF-së, Kompeticioneve të organizuara prej sajë dhe dizenjove të uniformave të ekipeve kombëtare;
5. FSHF dhe anëtarët e sajë gëzojnë të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve të dukshme të mjediseve sportive, ku zhvillonë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.
6. Komiteti Ekzekutiv i FSHF vendos se si dhe deri në çfarë mase përdoren këto të drejta dhe harton rregullore specifike për këto qëllime.
7. Vetëm Komiteti Ekzekutiv vendos nëse këto të drejta duhet të përdoren në mënyrë ekskluzive, bashkërisht me një palë të tretë ose tërësisht nga një palë e tretë.

VIII. SHPERBERJA

Neni 56 Vendimet

Cdo vendim që lidhet me shperberjen e FSHF, kërkon një shumicë prej 2/3 e votave të të gjithë delegatëve të FSHF që janë pjesëmarrës në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të thirrur për këto qëllime.

Neni 57 Dispozitat mbi pasuritë

Në rastin e shperberjes, Asambleja e Përgjithshme me 2/3 e votave vendos për përdorimin e pasurive neto duke reflektuar këto në kërkesën që i drejtohet gjykatës e cila do të aprovojë shpërndarjen.

IX. DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 58 Çështje që nuk janë parashikuar në Statut

Komiteti Ekzekutiv i FSHF duhet të zgjidhë në mënyrën e duhur dhe të drejtë, çdo çështje që nuk është parashikuar në këtë Statut

Neni 59 Miratimi dhe data e hyrjes në fuqi

1. Ky Statut u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme, e mbajtur më datë në 15.04.2019 dhe zëvendëson çdo Statut të mëparshëm të FSHF.
2. Statuti është aprovuar nga ministri përgjegjës për sportin në përputhje me ligjin;
3. Statuti hyn në fuqi me regjistrimin në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranës.